

OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.

RAPORTI TEKNIK

Objekti: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.

PROJEKT - ZBATIMI

DHJETOR 2025



PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK:

1. A. Hyrje:

Objekti që po trajtohet në këtë projekt ndodhet në njësi administrative Gjocaj në qytetin e Peqinit, pjesë e Bashkisë Peqin në Qarkun e Elbasanit, me një popullsi prej 26,136 banorësh sipas censusit të 2011, që i përket zonës së Shqipërisë së Mesme.

Në këtë zonë mbizoteron përgjithësisht një terren fushor - kodrinor.

Klima është e butë dhe me pak lageshti në periudhën dimërore, që shoqërohet me temperatura deri në -1°C , ndërsa temperatura mesatare vjetore është $15\div 35^{\circ}\text{C}$.

Me porosi të Bashkisë Peqin, është realizuar Projekti i Zbatimit për Ndërtimin e pritave lumore në shtratin e lumit Shkumbin, investim i cili është shumë i nevojshëm për permisimin e jetesës së banorëve të kësaj zone me një infrastrukturë bashkekohore, duke eliminuar kështu edhe rreziqet që sjellin vazhdimisht prurjet e rrembyeshme të lumit.

2. B. Gjendja Aktuale e Objektit:

Zona ku parashikohet ndërhyrja karakterizohet nga prurje sezonale të ujit dhe probleme të theksuara erozioni në brigjet e lumit. Kanali ekzistues i Darsisë është i amortizuar dhe nuk përmbush kërkesat për furnizim të qëndrueshëm me ujë. Mungesa e veprave mbrojtëse ka sjellë dëmtime të vazhdueshme të shtratit dhe brigjeve të lumit. Shtrati i lumit të Shkumbinit, i cili përshkon me gjurmen e tij edhe qytetin e Peqinit, paraqet rrezik të lartë herë pas here për shkak të prurjeve të tij të rrembyeshme.

Aktualisht zona nuk disponon infrastrukturë të mjaftueshme për ujitje të kontrolluar. Në periudha reshesh intensive, lumi del nga shtrati duke shkaktuar dëme në tokat bujqësore, ndërsa gjatë stinës së thatë mungon furnizimi i qëndrueshëm me ujë për ujitje. Zona e projektit ndodhet në territorin e bashkisë Peqin, përgjatë shtratit të lumit Shkumbin. Terreni karakterizohet nga reliev kryesisht fushor, me toka bujqësore të punueshme dhe me ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj përmbytjeve sezonale. Lumi Shkumbin paraqet luhatje të mëdha të nivelit të ujit gjatë vitit. Aksi i lumit ka një gjerësi të madhe dhe një thellesi mesatare 4 m por që varion sipas segmenteve paraqitura me saktësi në planin e rievimit. Mbrotja gjatësore ka synim kryesor mbrotjen e avancimit gjerësisht të tokës në këtë segment të përafërt prej 1110 m dhe ndërtimi i kanalit për ujitje në këtë gjatësi.

OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.

Per me teper, gjendja e rrezikshme qe paraqitet nga sa permendem me lart mund te dallohet edhe nga fotot e meposhtme:

3. C. Foto nga Gjendja Aktuale:



OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.



OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.



ZGJIDHJA E PROJEKTIT:

4. ZGJIDHJA TEKNIKE E PROPOZUAR :

Projekti parashikon ndërtimin e një kanali ujitës me seksion të përshtatshëm hidraulik për të përballuar prurjet e nevojshme për ujitje, veshjen e kanalit me beton për të reduktuar humbjet dhe erozionin. Gjithashtu kemi dhe ndërtimin e strukturave mbrojtëse përgjatë bregut të lumit (mure mbajtëse, argjinatura), vendosjen e veprave hidroteknike si porta rregulluese, dalje ujitëse dhe vepra shkarkimi. Si fillim punimesh do të kryhen germimet për devijimin e lumit. Me pas për ndërtimin e skarpatave si fillim do të bëhet pastrimi i aluvioneve të depozituara gjatë viteve.

Argjinatura ka një dhemb lidhës me blloqe betoni që shërben dhe si plate. Si fillim do të bëhen punimet e hapjes së themelit deri në tabanin ekzistues të lumit ku do të pozicionohen dhe dhembët e betoni të cilët do të jetojnë plotësisht të mbuluar nga uji.

- **Dimensionimi i kanalit është bërë bazuar në:**

1. Prurjen maksimale të nevojshme për ujitje
2. Karakteristikat hidrologjike të lumit Shkumbin
3. Koeficientët e sigurisë për përmbajtje
4. Seksioni i kanalit është projektuar në mënyrë që të sigurojë rrjedhje të qëndrueshme dhe të shmangë depozitimin e sedimenteve.

- **Dimensionimi i kanalit është bërë bazuar në:**

1. Stabilizim i brigjeve me struktura mbrojtëse
2. Parandalim i erozionit përmes veshjeve mbrojtëse
3. Kanalizim i kontrolluar i prurjeve gjatë reshjeve intensive

Për zgjidhjen e projektit është parashikuar :


- **Ndërtimi i vepres së marrjes:**

- **Përbërësit kryesorë:**


1. Prag marrjeje prej betoni
2. Grykë hyrëse me rrjetë mbrojtëse
3. Dhomë qetësimi
4. Strukturë rregulluese e prurjes

- **Vepra projektohet për të garantuar:**

1. Marrje të kontrolluar të ujit
2. Parandalim të futjes së materialeve të ngurta
3. Funksionim të sigurt gjatë prurjeve maksimale



PAMJE ANESORE/ ARMIMI
VEPRA E MARRJES



The figure consists of three parts illustrating reinforcement details:

- Top Diagram:** A cross-sectional view of a wall. It shows a semi-circular arch at the top. Reinforcement bars are numbered 1 through 8. Dimensions include a total height of 500mm, a base width of 250mm, and a radius of 150mm for the arch.
- Middle Diagram:** A plan view of the wall. It shows a rectangular section with a semi-circular end. Reinforcement bars are numbered 9 through 12. Dimensions include a length of 250mm and a radius of 150mm for the semi-circle.
- Bottom Diagram:** A section of the slab. It shows a rectangular section with a semi-circular end. Reinforcement bars are numbered 13 through 15. Dimensions include a length of 250mm and a radius of 150mm for the semi-circle.

OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.

- **Mbrojtje me mure gabioni L=10ml**

Karakteristikat teknike:

Gabione metalike të galvanizuara

Mbushje me gurë natyralë me rezistencë të lartë

Vendosje në formë tarracash ose mure mbajtëse


Trashësi tipike: 0.5 – 1.0 m (sipas projektit)

Gabionet sigurojnë:



Fleksibilitet strukturor

Rezistencë ndaj erozionit


Integrim natyror me mjedisin



Gabion filling and bracing placement



Link Gabion components





OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.

- **Mbrojtja me Blloqe Betoni L=587.6m**

Projekti ka ndikim pozitiv në zhvillimin bujqësor të zonës. Masat e parashikuara minimizojnë ndikimet negative mjedisore dhe përmirësojnë menaxhimin e ujërave sipërfaqësore. Zbatimi i këtij projekti do të rrisë sigurinë nga përmbytjet, do të përmirësojë ndjeshëm sistemin e ujitjes dhe do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të zonës së Peqinit.

Dhemb i betonit do të ndërtohet me blloqe betoni me permasa 1x1x1, të cilat janë të kapur me njëri-tjetrin me stafa Ø10 cdo 50cm gjithashtu do të kemi dhe gure gelqeror kave me permasa 0.8-1.2m të cilat do të vendosen sipër rreshtit të parë të blloqeve të betonit, gjë që ndihmon në shuarjen e presionit gerryhes të lumit kjo mbrojtje do të jetë në gjatësi prej L=587.6 m



OBJEKTI: “Ndërtim i Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë Njesia Adm- Gjocaj”.

Kanali është parashikuar të ndërtohet prej betoni të armuar, i projektuar për përçimin e sigurt të ujit dhe rezistencë ndaj ngarkesave hidraulike dhe mekanike.

Struktura e kanalit realizohet me:

- Beton të armuar të klasës **C25/30** (ose sipas projektit)
- Armaturë prej hekuri të tipit **B500B**
- **Zgare hekuri Ø10 mm**, e vendosur në të dy drejtimet (gjatësor dhe tërthor)
- Hapësirë ndërmjet shufrave **20 cm**

Zgarja metalike vendoset në fund dhe në anët e kanalit, duke respektuar mbulimin minimal të betonit sipas normave teknike, për të garantuar mbrojtjen nga korrozioni dhe jetëgjatësinë e veprës.

Para betonimit:

- Kryhet përgatitja e shtratit me shtresë zhavorri $t=20\text{cm}$
- Vendoset kallëpimi sipas dimensioneve të projektit
- Armatura fiksohet dhe distancohet për mbulim korrekt

Kanali realizohet me pjerrësi të projektuar për rrjedhje të lirë të ujit, pa grumbullime ose erozion lokal.

Pas betonimit:

- Sipërfaqja e brendshme përpunohet për të siguruar rrjedhje të rregullt
- Betoni kurohet sipas standardeve për arritjen e rezistencës së plotë
- Struktura të holla monolite betoni C 20/25 për kanalin $t=20\text{cm}$

Ky tip kanali siguron:

- Qëndrueshmëri strukturore
- Rezistencë ndaj gërryerjes dhe prurjeve të larta
- Funkcionim afatgjatë me mirëmbajtje minimale

PËRGATITI:

“AEG-Consulting” sh.p.k

Drejtues Teknik:

Ing. Lulzim SHENA